

Jehona Software sh.p.k.
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 –18

JEHONA SOFTWARE SH.P.K*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2020**

Shënime	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019
AKTIVE		
Aktive afatshkurtra		
Mjete monetare	4 1,548,246	7,267,972
Inventar	5 416,318	2,321,320
Llogari të arkëtueshme tregtare	6 551,711,232	87,116,662
Të tjera llogari të arkëtueshme	7 2,807,678	1,284,291
Instrumenta te tjera borxhi	8 18,038,941	18,058,887
Parapagime dhe shpenzime te shtyra	-	142,254,260
Totali i aktiveve afatshkurtra	574,522,415	258,303,392
Aktivët afatgjata		
Aktive afatgjata materiale	9 6,387,980	2,202,078
Aktive afatgjata jomateriale	10 213,000	213,000
Totali i aktiveve afatgjata	6,600,980	2,415,078
Totali i aktiveve	581,123,395	260,718,470
DETYRIMET		
Detyrime afatshkurtra		
Llogari të pagueshme tregtare	11 522,732,479	143,452,379
Detyrime ndaj punonjesve	12 1,292,313	-
Detyrime tatimore	13 4,073,388	3,774,506
Te ardhura te shtyra	-	79,887,680
Të tjera detyrime	14 452,918	333,774
Totali i detyrimeve afatshkurtra	528,551,098	227,448,339
Detyrime afatgjata	-	-
Totali i detyrimeve afatgjata	-	-
Totali i detyrimeve	528,551,098	227,448,339
Kapitali		
Kapitali i nënshkruar	15 5,595,600	5,595,600
Fitime të mbartura	27,674,531	-
Fitimi i vitit	22 19,302,166	27,674,531
Totali i kapitalit	52,572,297	33,270,131
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	581,123,395	260,718,470

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

Shënime	TOTAL 2020				
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Aktivitete ne fushen e zhvillimit e prodhimit software me 5% Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Aktivitete ne fushen e sherbimeve te tjera TIK me 15% Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	859,091,667	692,331,089	166,760,578	639,359,555
Total të ardhura		859,091,667	692,331,089	166,760,578	639,359,555
Lënda e pare, materiale të konsumueshme dhe të tjer	17	(604,853,053)	(487,443,411)	(117,409,642)	(555,367,496)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme		(604,853,053)	(487,443,411)	(117,409,642)	(555,367,496)
Shpenzime të personelit	18	(22,655,329)	(16,309,694)	(6,345,635)	(22,585,522)
Paga dhe shpërblime		(22,655,329)	(16,309,694)	(6,345,635)	(22,585,522)
Shpenzime amortizimi	19	(440,415)	(354,925)	(85,490)	(550,519)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	20	(209,194,279)	(168,587,019)	(40,607,260)	(28,191,425)
Shpenzime financiare	21	(1,354,054)	(1,091,215)	(262,839)	47,414
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(1,354,054)	(1,091,215)	(262,839)	47,414
Fitimi/humbja para tatimit	22	20,594,537	18,544,825	2,049,712	32,712,007
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin					
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	22	(1,292,371)	(936,901)	(355,470)	(5,037,476)
Fitimi/humbja e vitit		19,302,166	17,607,924	1,694,242	27,674,531
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin	22	19,302,166	17,607,924	1,694,242	27,674,531

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

JEHONA SOFTWARE SH.P.K*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

	Kapitali i nënshkruar	Fitimet e Pashpërndara	Fitim i vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2019	5,595,600	-	-	5,595,600
Fitimi i vitit			27,674,531	27,674,531
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	5,595,600	-	27,674,531	33,270,131
Fitim i pashperndare		27,674,531	-	27,674,531
Fitimi i vitit	-	-	19,302,166	19,302,166
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	5,595,600	27,674,531	19,302,166	52,572,297

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë aprovuar nga administratori i Jehona Software sh.p.k. më 30 Mars 2021 dhe janë firmosur si më poshtë:

Administrator
Helga Mustafaraj
Helga Mustafaraj


**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
<i>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</i>		
Fitim / Humbja e vitit	19,302,166	27,674,531
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	440,415	550,519
<i>Ndryshimet në aktivitet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie/(rritje) në inventar	1,905,002	27,168,591
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(323,843,751)	(129,153,109)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	301,102,759	51,974,898
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(1,093,409)	(21,784,571)
<i>Fluksi i Mjeteve Monetare nga / (përdorur në) aktivitetin e investimit</i>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(4,626,317)	(28,333)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(4,626,317)	(28,333)
<i>Fluksi i Mjeteve Monetare nga / (përdorur në) aktivitetin e financimit</i>		
Dividente të paguar	-	(33,366,322)
Mjete monetare neto nga / (përdorur në) aktivitetin e financimit	-	(33,366,322)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(5,719,726)	(55,179,226)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	7,267,972	62,447,198
Mjetet monetare në fund të periudhës	1,548,246	7,267,972

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

“Jehona Software” sh.p.k është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar pranë QKR me datë themelimi 02/10/2014 me NIPT L42202028V.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të Ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008 nga statuti i saj dhe legjislati në fuqi.

“Jehona Software” ka si objekt: Analizimin e informacionit dhe proceseve të punës, zhvillim dhe prodhim të programeve kompjuterike aplikative (software) në të gjitha platformat; shqyrtimin e nevojave në fushën e TIK si dhe projektimin e zgjidhjeve kompjuterike në fushën e TIK (*hardware, networking, programe kompjuterike "software" apo sisteme*), ndërtim, zhvillim, operim të qendrave të dhenave, administrimit të tyre, krijim i qendrave apo bazave të informacionit për grumbullimin, përpunimin apo shpërndarjen e sistemeve të informacionit; mirëmbajtje, azhurnim, upgrade të sistemeve dhe programeve kompjuterike etj, në bazë të të cilit plotëson kriteret e parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 730 datë 12.12.2018 “Për përcaktimin e aktiviteteve që përfshihen në fushën e prodhimit/zhvillimit të software-ve, si dhe për procedurat për aplikimin e tatimit fitimit nga persona juridike që ushtrojnë këto aktivitete” për të zbatimin e shkalles së reduktuar tatimore prej 5% të tatimit mbi fitimit.

Kontributi në shoqëri përfaqësohet nga kapitali i ortakut të vetëm 100%, Primus Adriatic d.o.o.

Administrator i Shoqërisë është Znj. Helga Mustafaraj.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në adresën : Tirane, Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Prokop Mima, Pallati Universal, Hyrja e Pare, Kati i Pare, Hyrja 1 A.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Kontabiliteti është organizuar dhe mbajtur në pajtim me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Dhe kërkesat e ligjit Nr.25/2018 datë 10 maj 2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa- mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**1.5.2 Provizionet**

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Llogarite ne monedhe te huaj jane konvertuar me kursin e Bankes se Shqiperise me 31.12.2020.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

<u>Kursi i këmbimit</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
EUR/Lek	123.70	121.77

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën nominale të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit nominal.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin nominal. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivitë. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

3.2. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.3 Inventarët (vazhdim)

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyresh	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Të tjera AAM	Vlera e mbetur	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Aktivitet Afatgjata Jomateriale

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse:

është e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktiviteti do të rrjedhin tek njësi ekonomike; dhe kosto e aktivitetit mund të matet me besueshmëri.

Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivitetit.

Njësi ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivitetit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët.

Një aktiv jo-material matet fillimisht me koston.

3.6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3. Politikat Kontabel (vazhdim)

3.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.8. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka qira operative.

3.9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.10. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

3.11. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.12. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare	1,548,246	7,267,972
Në Arke	-	129,358
Në banke	1,548,246	7,138,614
	<u>1,548,246</u>	<u>7,267,972</u>

5. Inventar

Inventari më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 është i paraqitur me poshte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mallra per rishitje	416,318	2,321,320
	<u>416,318</u>	<u>2,321,320</u>

6. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Klientë	551,711,232	87,116,662
	<u>551,711,232</u>	<u>87,116,662</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Tatim Fitimi i parapaguar	2,807,678	1,284,291
	<u>2,807,678</u>	<u>1,284,291</u>

8. Instrumente te tjera borxhi

Në këtë zë janë paraqitur instrumentet e tjere te borxhit 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Llogari ortaku	18,038,941	18,058,887
	<u>18,038,941</u>	<u>18,058,887</u>

JEHONA SOFTWARE SH.P.K

Shenimet shpjeguese per periudhen 1 Janar deri me 31 Dhjetor 2020

9. Aktive afatgjata materiale

	Mobilje dhe orendi	Mjete transporti	Pajisje informatike	Të tjera	Totali
<i>Kosto</i>					
Gjendja më 1 janar 2019	515,446	-	3,895,913	39,528	4,450,886
Shtesa			28,333	28,333	-
Nxjerrje jashtë përdorimit					-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	515,446	-	3,924,246	39,528	4,479,219
Shtesa		496,000	4,109,484	16,667	4,626,317
Nxjerrje jashtë përdorimit	4,167	-			
Gjendja më 31 dhjetor 2020	519,613	496,000	8,033,729	56,194	9,105,536
<i>Amortizimi i akumuluar</i>					
Gjendja më 1 janar 2019	295,008	-	1,403,263	11,177	2,724,264
Amortizimi i vitit	44,088	-	475,863	2,235	522,186
Nxjerrje jashtë përdorimit					
Gjendja më 31 dhjetor 2019	339,096	-	1,907,459	30,586	2,277,141
Amortizimi i vitit	35,270	-	403,357	1,788	440,415
Nxjerrje jashtë përdorimit					
Gjendja më 31 dhjetor 2020	374,366	-	2,310,816	32,374	2,717,556
<i>Vlera neto kontabël</i>					
Gjendja më 31 dhjetor 2019	176,350	-	2,016,787	8,942	2,202,078
Gjendja më 31 dhjetor 2020	145,247	496,000	5,722,913	23,820	6,387,980

10. Aktive afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Te drejtat e autorit	213,000	213,000
	<u>213,000</u>	<u>213,000</u>

11. Llogari te pagueshme tregtare

Llogarite e pagueshme tregtare me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Llogari te pagueshme	522,732,479	143,452,379
	<u>522,732,479</u>	<u>143,452,379</u>

12. Llogari të pagueshme ndaj punonjesve

Llogaritë e pagueshme ndaj punonjesve më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Te pagueshme ndaj punonjesve	1,292,313	-
	<u>1,292,313</u>	<u>-</u>

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	356,107	282,171
Detyrime për tatim fitimin	-	3,116,478
TVSH e pagueshme	3,361,152	-
Detyrime per tatimin e mbajtur ne burim	14,145	12,982
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	341,984	362,875
	<u>4,073,388</u>	<u>3,774,506</u>

14. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 për Shoqërinë vijnë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Parapagime	452,918	333,774
	<u>452,918</u>	<u>333,774</u>

15. Kapital i nenshkruar

Kapitali i nenshkruar më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Kapital i nenshkruar	5,595,600	5,595,600
	<u>5,595,600</u>	<u>5,595,600</u>

16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura totale	859,091,667	639,359,555
	859,091,667	639,359,555
	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	
Të ardhura nga aktivitete qe perfshihen ne fushen e zhvillimit/prodhimit software		692,331,089
Te ardhura te tjera ne fushen TIK		166,760,578
		859,091,667

17. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Shpenzimet për lëndë të para dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Kosto e sherbimeve te kryera	604,853,053	555,367,496
	604,853,053	555,367,496
	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	
Kosto e aktiviteteve qe perfshihen ne fushen e zhvillimit/prodhimit software		487,443,411
Kosto te tjera ne fushen TIK		117,409,642
		604,853,053

18. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime për paga	20,369,098	20,619,410
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	2,286,231	1,966,112
	22,655,329	22,585,522
	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	
Kosto personeli qe perfshihen ne fushen e zhvillimit/prodhimit software		14,355,045
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore per personelin qe eshte perfshire ne fushen e zhvillimit/prodhimit software		1,954,649
		16,309,694

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Kosto personeli qe perfshihen ne aktivite te tjera TIK	6,014,053
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore per personelin ne aktivite te tjera TIK	331,582
	6,345,635

19.. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Shpenzimet e amortizimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime amortizimi	440,415	550,519
	440,415	550,519

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shpenzime amortizimi qe lidhen me aktivite ne fushen e zhvillimit/prodhimit software	354,925
Shpenzime amortizimi te tjera ne fushen TIK	85,490
	440,415

20. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Sherbime te ndryshme per objektin e veprimtarise	162,147,137	21,109,823
Qira	2,080,415	3,077,658
Mirembajtje dhe riparime	1,805,425	1,485,556
Blerje energji, shp. karburant, etj.	922,520	1,251,778
Shpenzime administrative	513,291	871,164
Shpenzime postare, telekomunikacion	474,061	395,446
	209,194,279	28,191,425

Shpenzime te ndryshme qe lidhen me me aktivite ne fushen e zhvillimit/prodhimit software:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Sherbime te ndryshme per objektin e veprimtarise	163,916,328
Qira	1,676,580
Mirembajtje dhe riparime	1,454,969
Blerje energji, shp. karburant, etj.	743,447
Shpenzime administrative	413,655
Shpenzime postare, telekomunikacion	382,040
	168,587,019

Shpenzime te tjera ne fushen TIK:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Sherbime te ndryshme per objektin e veprimtarise	39,482,239
Qira	403,835
Mirembajtje dhe riparime	350,456
Blerje energji, shp. karburant, etj.	179,073
Shpenzime administrative	99,636
Shpenzime postare, telekomunikacion	92,021
	40,607,260

21. Shpenzimet financiare

Shpenzimet financiare detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime interesi	(272)	-
Të ardhura nga interesi	987	2,687
Fitim/(Humbje) kembime valutore	(1,354,769)	44,727
	(1,354,054)	47,414

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shpenzime financiare per aktivitete qe perfshihen ne fushen e zhvillimit/prodhimit software	(1,091,215)
Shpenzime financiare te tjera ne fushen TIK	(262,839)
	(1,354,054)

22. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 Duke qene se shoqeria ofron sherbime ne fushen e prodhimit/zhvillimit software ne zbatim te pikes 2, te nenit 28 te ligjit nr.8438 date 28.12.1998 te ndryshuar ajo aplikon shkallen tatimore te tatim fitimit prej 5% dhe per aktivitete te tjera ne fushen e Teknologjise se Informacionit dhe Komunikimit (TIK) aplikon normen standarte te tatim fitimit prej 15%.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
	Norme Tatim Fitimi 5%	Norme Tatim Fitimi 15%
<i>Fitimi para tatimit</i>	18,544,825	2,049,712
Shpenzime të panjohura	193,200	320,090
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	18,738,025	2,369,802
Tatim fitimi 5% /15%	(936,901)	(355,470)
Fitimi neto	17,607,924	1,694,242

23. Ngjarje pas bilancit

Ndersa situata pandemike COVID-19 ende po evulon ne Shqiperi dhe ne mbare boten, ka pasiguri te larte mbi shtrirjen e saj ne kohen e leshimit te ketyre pasqyrave financiare. Si pasoje, menaxhimi nuk eshte ne gjendje te vleresoje me siguri dhe te siguroje nje vleresim sasior te ndikimit te mundshem te kesaj pandemie ne kompani. Ndersa masat kufizuese vazhdojne, volumi i shitjeve, fluksi i parase (zhvleresimi i aktiveve, vlera e drejte ejt) dhe fitimi mund te ndikohen. Sidoqofte, ne daten e ketyre pasqyrave financiare, shoqeria po operon, vazhdon te permbushe detyrimet e saj ne kohen e duhur dhe per kete arsye vazhdon te zbatoje parimin e vijemesise ne pergatitjen e pasqyrave financiare.
